



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 11.04.2023

Nr: 54

Ora: 13:00

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 11, DATË 25.03.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Armando Subashi, Kryetar në Bashkinë Fier; z. Nuri Belba, Kryetar në Bashkinë Prrenjas; z. Kastriot Gurra, Kryetar në Bashkinë Librazhd; personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në institucionet:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Bashkia Poliçan; Bashkia Skrapar;
Bashkia Roskovec; Bashkia Lezhë; Bashkia Bulqizë; Bashkia Elbasan.

BAZË LIGJORE:

Neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008,
“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në kuadër të procedurave për mbikëqyrjen e procesit të raportimeve për veprimtaritë publike të institucioneve shtetërore, ka konstatuar se nga ana e 10 (dhjetë) institucioneve janë kryer shkelje administrative të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, ku tre institucione kanë pasur aktivitete publike të raportuara, por kanë lejuar përdorimin e burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore; dhe shtatë institucione nuk kanë raportuar veprimtaritë e tyre publike në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj Z. Armando Subashi, Kryetar në Bashkinë Fier; z. Nuri Belba, Kryetar në Bashkinë Prrenjas; z. Kastriot Gurra, Kryetar në Bashkinë Librazhd si persona përgjegjës për organizimin e veprimtarive publike.
3. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se aktivitetet publike janë raportuar në respektim të afateve ligjore, por ka pasur përdorim të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Komisioneri ka vendosur t’i kërkojë KAS-it marrjen e masës administrative gjobë ndaj organizatorëve të këtyre aktiviteteve z. Armando Subashi, z. Nuri Belba si dhe z. Kastriot Gurra në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
4. Komisioneri ka nisur gjithashtu hetimin administrativ ndaj personave përgjegjës të institucioneve publike për raportimin e veprimtarive publike, si më poshtë:

- Zj. Ledina Agalliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Zj. Luljeta Xhaja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Poliçan;
- Zj. Rudina Llango, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Skrapar;
- Zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Roskovec;
- Z. Reinis Çela, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Lezhë;
- Z. Leonard Daci, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Bulqizë;
- Z. Shefqet Bullari, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në Bashkinë Elbasan.

5. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se aktivitetet publike nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së dhe ka vendosur t'i kërkojë KAS-it marrjen e masës administrative gjobë ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të këtyre institucioneve në shumën 5 000 lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
6. KAS-i caktoi me short z. Ledio Braho relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023 të Komisionerit dhe në seancën e shqyrtimit paraprak të datës 28.03.2023 vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke caktuar si datë për shqyrtimin e saj datën 29.03.2023.
7. Seanca e datës 29.03.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të specialistëve të administratës së KQZ- së dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Librazhd z. Bajram Pishkashi, në cilësinë e përfaqësuesit. Palët e tjera, të njoftuara rregullisht, nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 11, datë 25.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendim nr. 200, date 24.12.2023, “Për shqyrtimin administrativ ndaj kryetarit të Bashkisë Fier, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- Vendim nr. 201, date 24.12.2023, “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

KAS-i konstatoi:

1. Lidhur me kërkesën për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj z. Armando Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier, mbështetur në denoncimet e **regjistruara me nr. 40, 41, 127 ID**, mund të konstatohet:
 - i) Sanksioni është kërkuar të vendoset për shkak se Kryetari i bashkisë Fier, në takimet e denoncuara, “...nuk ka mundur të ndalojë përdorimin e thirrjeve me përmbajtje elektorale nga ana e pjesëmarrësve”. Ky formulim është i paqartë dhe konfuz. Në vlerësimin e Komisionerit duket sikur Kryetari i Bashkisë Fier ka qenë i vendosur përpara detyrimit ligjor që të ndalonte fjalimet apo ndërhyrjet me karakter politik ose elektorale në veprimtarinë e organizuar prej tij. “Në rastet kur të ftuarit ose folësit, në fjalimet e tyre kanë thirrje me përmbajtje partiake ose zgjedhore në favor të një subjekti zgjedhor apo të një kandidati dhe dalin përtej objektit dhe tematikës së takimit, organizatorit të aktivitetit i lind detyrimi të marrë gjithë masat e nevojshme”, ka arsyetuar Komisioneri në kërkesë.
 - ii) Kryetari i bashkisë është organ me natyrë politike, sikurse është i tillë këshilli bashkiak, Kuvendi, Këshilli i Ministrave apo Kryeministri. Veprimtaritë publike të kryetarit të bashkisë janë në shumicë veprimtari politike. Ato organizohen për qëllime politike, siç është përcjellja e mesazheve politike, promovimi i nismave politike, festimi i arritjeve politike, tërheqja e publikut rreth platformës së tij politike etj. Veprimtaritë publike nuk ndahen dot nga qëllimi

politik i tyre. Në prag zgjedhesh nuk ndahen dot as nga qëllimi elektoral. Por, a e bëjnë prononcimet me përmbajtje politike ose elektorale veprimtarinë apriori të kundërligjshme? Përgjigja është jo, jo automatikisht, jo vetvetiu.

- iii) Komisioneri duhet të kishte identifikuar saktësisht shkeljen e kryer, duhet të kishte dhënë referencën e saktë ligjore për të, duhet të kishte bërë analizën ligjore dhe të fakteve, përpara se të kërkonte masën administrative.
- iv) Kodi zgjedhor nuk përmban në asnjë dispozitë të tij detyrimin “të ndalojë (në veprimtaritë publike që organizon) përdorimin e thirrjeve me përmbajtje elektorale nga ana e pjesëmarrësve”. Përfaqësuesit e administratës së KQZ-së referuan tek neni 7 i vendimit të Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, i cili është nen që formulon detyra për një numër drejtuesish të institucioneve, përfshirë kryetarin e bashkisë. Formulimi “të ndalojë (në veprimtaritë publike që organizon) përdorimin e thirrjeve me përmbajtje elektorale nga ana e pjesëmarrësve” mungon në listën e detyrave. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në nenin 7 të vendimit nr. 9 kanë lidhje me masat që duhet të marrin drejtuesit e institucioneve për të mos lejuar zhvillimin e “veprimtarive të ndaluara”.
- v) Komisioneri ka hetuar të tre rastet, por nuk ka mundur të identifikojë, eventualisht provojë, ekzistencën e asnjë shkakut që do ta vendoste Kryetarin e Bashkisë Fier përpara përgjegjësisë për organizimin dhe zhvillimin e një “veprimtarie të ndaluar”.
- vi) Kryetarin të bashkisë nuk i lejohet që të përdorë ose të vërë në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE** burime të institucionit që drejton (pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor), si në formën e aseteve, ashtu dhe në formën e burimeve njerëzore. Rastet e denoncuara janë qartësisht raste, ku së paku asetet e Bashkisë Fier janë vënë “në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose koalicioneve”. Takimet e denoncuara kanë pasur, përtej çdo dyshimi, një përmbajtje tërësisht politike, me prononcime thellësisht propagandistike, qartësisht në favor të qeverisjes. Por, a janë zhvilluar ato **NË ZGJEDHJE**, apo **JASHTË ZGJEDHJEVE**? Për këtë Komisioneri dhe përfaqësuesit e tij nuk kishin një përgjigje të mbështetur në ligj, nuk kishin një përgjigje të ligjshme.

- vii) Çështja që kishte nevojë të zgjidhej, por që nuk është zgjidhur sot e kësaj dite, është se kur Kodi ndalon që disa ngjarje të ndodhin **NË ZGJEDHJE**, cilës periudhë kohore i referohet? Kodi ka përcaktuar periudhën e fushatës zgjedhore, si një periudhë që zgjat nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve, deri 24 orë para datës së zgjedhjeve (neni 77), ka përcaktuar periudhën kur nuk lejohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve të caktuara ligjore ose nënligjore, e cila është katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve (pika 4 e nenit 91), por nuk ka përcaktuar periudhën që përfshin termi **ZGJEDHJE**, nuk ka përcaktuar kur fillon ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 dhe as kur ai mbaron. Nga ana tjetër, vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 nuk e ka saktësuar këtë përkufizim. Në nënpikën 1.3, të pikës 1 të nenit 3 të tij, teksta jep përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara”, vendimi vendos afatin për të cilin vepron ndalimi për secilën nga kategoritë e veprimtarive të ndaluara, me përjashtim të veprimtarive të përkufizuara nga shkronja “c’ dhe nga shkronja “dh” e tij, për të cilat nuk ka afat.
- viii) Përfaqësuesit e administratës së KQZ-së deklaruan në seancë, se në gjykimin e tyre ndalimi sipas pikës 1 të nenit 91 duhet të shtrihej në periudhën nga 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, deri në datën e zgjedhjeve, “ndryshe nuk ka kuptim pse raportimi i veprimtarive kërkohet për këtë periudhë” (sic). Ky është deduksion logjik, nuk është referencë ligjore. Deduksionet logjike mund edhe të mirëprehen si racionalë nga ana e anëtarëve të KAS-it, por duhet pranuar se ato nuk mund të konsiderohen si detyruese për Kryetarin e Bashkisë Fier. Kompetencën për t’i bërë ato detyruese nuk e ka KAS-i, as Komisioneri, sepse nuk e kanë tagrin për të nxjerrë akte me karakter normativ. Kompetencën e ka Rregullatori, i cili ka marrë autorizimin nga Kodi Zgjedhor për të nxjerrë “udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike”. Vetëm Rregullatori mund t’a shndërrojë deduksionin illogjik në normë. Vetëm pas kësaj, kërkimet e komisionerit, si në rastet e denoncuar të Bashkisë Fier, mund të procedohen dhe ndëshkohen administrativisht.
- ix) Kryetari i Bashkisë Fier nuk mund të sanksionohet administrativisht për veprime, të cilat nuk është ligjorisht e qartë nëse janë kryer brenda apo jashtë periudhës së ndalimit. Kuadri ligjor i paqartë nuk mund të zbatohet në dëm të subjekteve.

2. Arsyetimi i mësipërm vlen edhe për trajtimin e kërkesës së Komisionerit për marrjen e masës administrative ndaj z. Nuri Belba, Kryetar i Bashkisë Prrenjas, në çështjen e regjistruar me nr. 128 ID. Për më tepër, në këtë çështje nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të burimeve shtetërore, d.m.th. nuk ka asnjë të dhënë, se veprimtaria do konsiderohej veprimtari e ndaluar edhe nëse do zhvillohej **NË ZGJEDHJE**. Lidhja me institucionin e Bashkisë Prrenjas provohet vetëm nga raportimi në ndërfaqen e KQZ-së për veprimtaritë publike. Përndryshe, veprimtaria do ishte thjesht takim i dy politikanëve me një grup pensionistësh, në një mjedis publik.
3. Takim politik (veprimtari joinstitucionale) dhe pa asnjë gjurmë përdorimi të burimeve të institucionit është dhe rasti i denoncuar me denoncimin nr. 4 ID për veprimtarinë e raportuar nga Bashkia Librazhd. Prova atashuar kërkesës është një link nga TV Klan, i cili ka referuar për veprimtarinë, si një veprimtari e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Socialiste, z. Damian Gjijnuri. Kryetari i Bashkisë Librazhd rezulton personalisht pjesëmarrës në takim, por nuk ka asgjë që provon përfshirjen e institucionit të bashkisë as në pjesëmarrje, as në organizimin e veprimtarisë. Analiza e faktit juridik çon në konkluzionin se Bashkia Librazhd nuk duhet ta kishte raportuar këtë veprimtari, sepse nuk ka qenë organizatore e saj.
4. I njëjti arsyetim vlen edhe për veprimtaritë e regjistruara me nr. 51 dhe 53 ID të kryetarit të Bashkisë Elbasan. Këto dy veprimtari nuk janë raportuar nga ana e bashkisë Elbasan. Siç rezulton nga provat e administruara nga faqja *facebook* e z. Damian Gjijnuri, kryetari i bashkisë Elbasan është pjesëmarrës në një takim vizitë që Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste ka zhvilluar në terren. Veprimtaritë nuk shfaqin gjurmë që mund t'i lidhin ato me institucionin e bashkisë Elbasan.
5. Denoncimi i regjistruar me nr. 64 ID ndaj Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, denoncimi i regjistruar me nr. 124 ID ndaj Bashkisë Bulqizë dhe denoncimet e regjistruara me nr. 54 dhe 55 ID ndaj Bashkisë Poliçan bëjnë fjalë për veprimtari publike të pa raportuara në ndërfaqen e KQZ-së për veprimtaritë publike. Komisioneri ka hetuar dhe identifikuar drejt përgjegjësinë e zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për denoncimin me nr. 64 ID, përgjegjësinë e z. Leonard Daci, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Bulqizë, për denoncimin me

nr. 124 ID, si dhe përgjegjësinë e zj. Luljeta Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Poliçan, për denoncimet me nr. 54 dhe 55 ID.

6. Denoncimi i regjistruar me nr. 88 ID ndaj Bashkisë Roskovec bën fjalë për veprimtari që është zhvilluar në mjediset e punës dhe në shërbim të agjendës institucionale. Veprimtaria nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së për veprimtaritë publike, ndonëse personat përgjegjës për raportimin kanë qenë përpara detyrimit formal për raportim. KAS-i çmon se takimet e punës që zhvillohen në mjediset e institucionit, në zbatim të agjendës dhe kompetencave institucionale, me persona ose grupe personash, duhet të ndahen nga kategoria e veprimtarive publike dhe të çlirohen nga detyrimi për raportim, sa kohë që ato nuk kanë lidhje dhe nuk i shërbejnë interesave elektorale të ndonjë subjekti politik. Por për këtë duhet që KQZ-ja të përpunojë udhëzime të qarta zbatuese për të gjitha palët e përfshira. KAS-i çmon se në këtë rast dhe për këtë sensibilitet është më e preferueshme që të hiqet dorë nga masa administrative dhe të nxitet KQZ-ja që t'a kodifikojë sa më shpejt rastin.
7. Komisioneri ka kërkuar marrjen e masës administrative ndaj personit përgjegjës për raportimet në Bashkinë Skrapar, për shkak se nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, të regjistruar me nr. 79 ID. Denoncimi ka lidhje me një postim (foto) në faqen zyrtare të bashkisë në *facebook*. Gjatë shqyrtimit rezultoi se administrata e KQZ-së e kishte të pamundur të identifikonte nëse kryetari i bashkisë kishte marrë pjesë në veprimtari, apo jo. Detyrimi për raportim është në fuqi për veprimtaritë e subjekteve të përcaktuara. Kryetari i bashkisë bën pjesë në këtë kategori. Por, nëse hetimi administrativ i kryer e ka pasur të pamundur t'a identifikonte atë, atëherë edhe për KAS-in duhet të rezultojë e pamundur që të ngarkojë me përgjegjësi administrative personin përgjegjës, për rrethana faktike të paqarta dhe të pasigurta.
8. Komisioneri ka kërkuar marrjen e masës administrative ndaj personit përgjegjës për raportimet në Bashkinë Lezhë, për mosraportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të 6 (gjashtë) veprimtarive publike, të regjistruara me nr. 15, 31, 96, 97, 121, 126 ID. Veprimtaritë e denoncuarat janë veprimtari publike, përveç veprimtarisë me nr. 121 ID, e cila është inspektim në një kantier pune, ku nuk ka prani të publikut. Për 5 (pesë) veprimtaritë publike të pa

raportuara duhet të mbajë përgjegjësi sipas ligjit z. Reinis Çela, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Lezhë.

9. Komisioneri ka kërkuar marrjen e masës administrative ndaj personit përgjegjës për raportimet në Bashkinë Ebasan, për mosraportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të veprimtarisë së regjistruar me nr. 52 ID. Siç rezulton nga prova e administruar nga faja *facebook* e kryetarit të bashkisë Elbasan, kryetari i bashkisë Elbasan është pjesëmarrës në një takim vizitë që Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Socialiste ka zhvilluar në terren. Veprimtaria e denoncuar është veprimtari publike. Lidhja me institucionin e bashkisë Elbasan provohet nga promovimi i saj nëpërmjet faqes së *facebook* të kryetarit të bashkisë, e cila përdoret rregullisht prej tij për promovimin e veprimtarive në funksionin e tij si zyrtar. Për këto veprimtari publike të pa raportuara duhet të mbajë përgjegjësi sipas ligjit z. Shefqet Bullari, Drejtor, Bashkia Elbasan.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS, në seancën e datës 11.04.2023,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 2.1 Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5,000 (pesë mijë) lekë sipas nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor ndaj Znj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për mosraportim të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike sipas nenit 92 pika 6 të K.Zgjedhor.
- 2.2 Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5,000 (pesë mijë) lekë sipas nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor ndaj znj. Luljeta Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Poliçan, për mosraportim të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike sipas nenit 92 pika 6 të K.Zgjedhor;

2.3 Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 7,000 (shtatë mijë) lekë sipas nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor ndaj z. Reinis Çela, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Lezhë, për mosraportim të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike sipas nenit 92 pika 6 të K.Zgjedhor;

2.4 Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5,000 (pesë mijë) lekë sipas nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor ndaj z. Leonard Daci, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Bulqizë, për mosraportim të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike sipas nenit 92 pika 6 të K.Zgjedhor;

2.5 Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 5,000 (pesë mijë) lekë sipas nenit 171 pika 1 të K.Zgjedhor ndaj z. Shefqet Bullari, Drejtor i Koordinimit dhe Statistikave pranë Bashkisë Elbasan, për mosraportim të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike sipas nenit 92 pika 6 të K.Zgjedhor;

3. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për kërkimet e tjera;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Ledio BRAHO - Relator (Pjesërisht kundër)

Elvis ÇEFA - Anëtar (Pjesërisht kundër)

Elvin LAKO - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt *“Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord pjesërisht me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ edhe ndaj:

- z. Armando Subashi, Kryetar në Bashkinë Fier;

- personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Bashkinë Skrapar;

- personit përgjegjës në Bashkinë Roskovec;

- personit përgjegjës në Bashkinë Elbasan edhe për dy aktivitete të tjera për të cilat shumica e anëtarëve të KAS ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

2. Në lidhje me Bashkinë Fier, KSHZ i është drejtuar KAS me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të bashkisë për tre aktivitete. Të tre aktivitetet kanë qenë të organizuar nga Bashkia Fier dhe të raportuara në ndërfaqen e KQZ po nga Bashkia Fier. Në të tre aktivitetet, përveç pjesëmarrësve, kanë qenë të pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Fier, z. Taulant Balla dhe në një prej tyre edhe deputeti i Partisë Socialiste i Qarkut Fier, z. Petro Koçi.

Aktiviteti i parë është raportuar nga Bashkia Fier me titull *“Komuniteti i Njesisë Administrative Dermenas ka paraqitur pranë njësisë një kërkesë me shkrim, ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë”*. Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Fier, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur *“Bujqësia motor i zhvillimit të Fierit. Saliu shqetësohet për hallet e veta, 21 Janarin dhe Gerdecin”*.

Aktiviteti i dytë është raportuar nga Bashkia Fier me titull *“Komuniteti i Njesisë Administrative Topojë ka paraqitur një kërkesë pranë njësisë, ku ka kërkuar një takim me kryetarin e bashkisë”*

për t'u njohur nga afër me investimet që janë parashikuar të bëhen në zonën e tyre nga Bashkia Fier gjatë vitit 2023". Nga fjala e drejtuesit politik të PS qarku Fier, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur "10 vjet e ka patur Bashkinë Partia Demokratike por as një kilometër rrugë nuk u shtrua. Partia Socialiste krahasohet vetëm me veten, jo me të tjerët sepse duhet të shohim se ku jemi dhe çfarë të bëjmë më mirë. Ne jemi çdo ditë në terren me njerëzit për të biseduar me ta, por Non-Grata i madh ka një hall që ne nuk ja zgjidhim dot sepse halli i tij është drejtësia. Ju vetë e patë që sapo doli një provë e re e pakontestueshme se si ishin dhënë urdhrat më 21 Janar 2011 për të qëlluar në trupat e protestuesve, dhe çfarë bëri, sapo doli kjo provë e re, u mundua të heqë vëmendjen nga kjo çështje dhe duhetj të shkohej në një çështje tjetër."

Aktiviteti i tretë është raportuar nga Bashkia Fier, por është pasqyruar në një datë tjetër. Nga fjala e kryetarit të Bashkisë Fier në këtë takim, që është publikuar në rrjetin e tij social Facebook, vërehet se ndër të tjera ai është shprehur si vijon "ME NJERËZIT PËR NJERËZIT - Mbrostar, Fier - Ne do të vijojmë me projektet e rëndësishme infrastrukturore në Bashkinë e Fierit falë mbështetjes së qeverisë @Edi Rama - Sondazhet konfirmojnë një fitore shumë të thellë tonën #14Maj2023. Nga ana tjetër Aleanca e Rublave Berisha-Meta do të vazhdojnë protestat kundër drejtësisë për interesat e tyre personale. Por siç thotë populli "Qentë le të lehin, karvani shkon përpara". Na duhet që të gjithë sëbashku të vijojmë me punën dhe të realizojmë çdo premtim të dhënë për banorët e Mbrostarit dhe të Fierit, me një fokus të veçantë #BUJQËSIA".

Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimeve në aktivitetet e sipërcituara që janë organizuar nga Bashkia Fier, janë mbajtur fjalime me përmbajtje politike dhe elektorale nga përfaqësuesi politik i PS në Fier apo dhe nga vetë Kryetari i Bashkisë Fier.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë "... **me synim**

garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake". Në nenin 7 shkronjat "dh" dhe "e" të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se "1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësisive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ... v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore".

Për ne anëtarët në pakicë, është e qartë që shfrytëzimi i aktiviteteve të organizuara nga Bashkia Fier për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike apo për të anatemuar kundërshtarin politik të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë, cënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të dilej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ato të organizuara nga Bashkia Fier nuk çenojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Fier, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Fier dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Fier; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Fier me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim të fushatës

zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Fier apo Kryetari i Bashkisë Fier.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Fier, z. Armando Subashi.

3. Në lidhje me Bashkinë Skrapar, rezulton se Bashkia Skrapar, në faqen e saj në rrjetin social *Facebook* ka publikuar zhvillimin e një aktiviteti me përshkrimin “Ditën e sotme, datë 7 shkurt 2023, Bashkia Skrapar zhvilloi një takim informues, për projektin e fituar në kuadër të thirrjes EU4 for Municipalities, Ndërtimi i një Qendre Sportive, në shkollën 9 vjeçare "Zylyftar Veleshnja. Në takim morën pjesë, mësues dhe nxënës të shkollës 9 vjeçare "Zylyftar Veleshnja", përfaqësues nga komuniteti, si dhe përfaqësues të projektit BE për bashkitë”, duke e shoqëruar edhe me 30 fotografi këtë postim. Nga fotografitë vërehet një numër i konsiderueshëm pjesëmarrësish që përfaqësojnë mësues dhe nxënës të shkollës “Zylyftar Veleshnja”, apo përfaqësues nga komuniteti çka mund të konsiderohen fare mirë publik. Po ashtu Bashkia Skrapar ka refuzuar praninë e saj si gjatë hetimit administrativ pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, edhe në KAS, në mënyrë që ta sqaronte faktin nëse aktiviteti ka qenë i hapur për publikun apo jo.

Që një aktivitet të raportohet, ai duhet të konsiderohet veprimtari publike. Në lidhje me “veprimtarinë publike” vetë K.Zgjedhor, në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 92 të tij, parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*. Në lidhje me faktin nëse publikimet në faqen e Bashkisë Skrapar në rrjetin social *Facebook*, konsiderohen apo jo veprimtari publike, në anëtarët në pakicë vijojmë të kemi qasjen se së pari përdorimi i rrjeteve sociale patjetër që ka në agjendë informimin e publikut që është një nga kushtet e mjaftueshme për ta kualifikuar një veprimtari si publike, por së dyti përputhet dhe me interpretimin teleologjik (qëllimor) që i bëhet nenit 92 të K.Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie,

entete shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” në lidhje me vendosjen e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. **Për më tepër, masivizimi i përdorimit të rrjeteve sociale bën që propaganda kryesore të kryhet pikërisht nëpërmjet shpërndarjes së mesazheve/fotove/videove në to, çka do të thotë se moskonsiderimi i përdorimit të tyre si “veprimtari publike”, do t’i shndërronte dispozitat e sipërcituara si të pazbatueshme dhe për rrjedhojë nuk do të arrihej synimi për garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.**

Për sa më sipër, kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës në Bashkinë Skrapar, për në anëtarët në pakicë të KAS, është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në prova.

4. Në lidhje me Bashkinë Roskovec, në anëtarët në pakicë, i qëndrojmë të njëjtave argumente si më sipër në rastin e Bashkisë Skrapar, pasi sërish kemi të bëjmë me një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish të pranishëm në aktivitet, por dhe njëkohësisht aktivitet i publikuar në rrjetin social *Facebook*, ndaj duhet të ishte pranuar kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës në Bashkinë Roskovec.
5. Në lidhje me Bashkinë Elbasan, shumica e anëtarëve të KAS kanë arritur në konkluzionin se dy nga aktivitetet e raportuara nga Bashkia Elbasan, nuk janë në shkelje të K.Zgjedhor sa i përket mosraportimit të tyre, më konkretisht aktivitetet në Gjinar, Elbasan dhe në ambientet e mobileri “Beta” po në Elbasan. Në të dy aktivitetet, përveç kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe drejtuesit politik të Partisë Socialiste në qarkun e Elbasanit, kanë qenë të pranishëm edhe punëmarrës të subjekteve tregtare që janë vizituar gjatë punës së tyre. Në anëtarët në pakicë të KAS, pranojmë

si të drejtë argumentin e KSHZ se “... aktivitetet e kryera nga z. Gledian Llatja në praninë e drejtuesit politik të qarkut përbëjnë veprimtari publike në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Referuar pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor “formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”. Neni 91, nuk e kufizon në një numër të caktuar se sa persona duhet të jenë të pranishëm për ta quajtur aktivitetin “publik”. Pjesëmarrja e medias nuk është i vetmi element që e bën aktivitetin të konsiderohet si publik, por duhet të merren në konsideratë edhe element të tjerë, siç është numri i pjesëmarrësve në këto takime. Të ndodhur në kushtet, që në bizneset ku z. Llatja ka kryer takimet, ka pasur prezent punonjës, aktiviteti duhet të konsiderohet si “i hapur” për gjithë punonjësit që kanë qenë prezent në atë moment. Përsa më sipër, referuar nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, personi përgjegjës ka pasur detyrimin për raportim të aktiviteteve të mësipërme”. Pikërisht për këto arsye, duhet të ishte pranuar kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës në Bashkinë Elbasan edhe për këto dy aktivitete të tjera publike të paraportuara.

Anëtarë: Elvis Çefa, Ledio Braho

MENDIM SHITESË I ANËTARIT NË PAKICË LEDIO BRAHO

1. Në shqyrtimin e kërkesës nr. 11, datë 25.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me objekt “Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ”, unë, anëtari në pakicë, duke mos qenë dakord pjesërisht me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jam i mendimit se KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ edhe ndaj:

- z. Nuri Belba, Kryetar në Bashkinë Prrrenjas;

- z. Kastriot Gurra, Kryetar në Bashkinë Librazhd

- personit përgjegjës në Bashkinë Lezhë edhe për aktivitetin tjetër për të cilin shumica e anëtarëve të KAS ka vendur rrezimin e kërkesës.

2. Në lidhje me Bashkinë Prrenjas, KSHZ i është drejtuar KAS me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të bashkisë për një aktivitet. Aktiviteti ka qenë i organizuar nga Bashkia Prrenjas dhe është raportuar në ndërfaqen e KQZ po nga Bashkia Prrenjas. Në aktivitete, përveç pjesëmarrësve, ka qenë i pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri.

Nga fjala e kryetarit të Bashkisë Elbasan, z. Nuri Belba, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur se *“Së bashku me Damianin bashkëbiseduam me pensionistë dhe veteran të Prrenjasit. Qeveria ka treguar vëmendje të veçantë ndaj moshës së tretë duke ofruar përkujdesje dhe mbështetje jo vetëm për shpërblimin e fundvitit por edhe me bonusin e Pakos së Madhe”* apo *“... qyteti brenda 4 viteve ishte transformuar duke njohur investime të rëndësishme falë dhe mbështetjes së qeverisë socialiste ...”*.

Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimit në aktivitetin e sipërcituar që është organizuar nga Bashkia Prrenjas, është mbajtur një fjalim me përmbajtje politike dhe elektorale nga vetë Kryetari i Bashkisë Prrenjas.

Komisioni Rregullator pranë KQZ, në zbatim të detyrimeve të parashikuara nga nenet 90 dhe 92 të K.Zgjedhor, ka nxjerrë vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Në nenin 1 të këtij vendimi që përcakton qëllimin dhe objektin e tij, Komisioni Rregullator, ka përcaktuar se ky akt normativ është nxjerrë **“... me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të**

partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake". Në nenin 7 shkronjat "dh" dhe "e" të këtij vendimi ku parashikohen detyrat e sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë, ndër të tjera parashikohet se ***"1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë: ... dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse; e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e: ... v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore"***.

Për mua anëtarin në pakicë, është e qartë njësoj si në rastin e Bashkisë Fier, që shfrytëzimi i aktivitetit të organizuar nga Bashkia Prrenjas për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike në favor të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë, çënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje. Nëse një sjellje e tillë e një kryetari bashkie nuk do të konsiderohej në kundërshtim me qëllimin dhe objektin e vendimit të sipërcituar të Komisionit Rregullator, atëherë duhet të pranojmë se kemi të bëjmë me një akt normativ të pazbatueshëm. Po në të njëjtin përfundim do të arrihej edhe në lidhje me nenin 91 të K.Zgjedhor nëse do të pranohet që aktivitete si ai i organizuar nga Bashkia Prrenjas nuk çënojnë sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike. Është alogjike të mendosh se një aktivitet i organizuar nga Bashkia Prrenjas, mund të organizohet pa përdorur asnjë burim të saj, në kuptim të burimeve sipas nenit 91 të K.Zgjedhor. Dy janë mundësitë për të organizuar aktivitete të tilla: 1. Aktivitet i organizuar nga Bashkia Prrenjas dhe që ka përdorim të burimeve të Bashkisë Prrenjas; ose 2. Aktivitet politik i kandidatit për Bashkinë Prrenjas me burime që duhet të deklarohen nga partia politike që e mbështet ose vetë kandidati në kuptim

të fushatës zgjedhore. Një aktivitet me status të ndryshëm nga këto më sipër, nuk mund të ketë ku organizator të jetë Bashkia Prrenjas apo Kryetari i Bashkisë Prrenjas.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, z. Nuri Belba.

3. Në lidhje me Bashkinë Librazhd, KSHZ i është drejtuar KAS me kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarit të bashkisë për një aktivitet me temë “Takim me pensionistët”. Aktiviteti ka qenë i organizuar nga Bashkia Librazhd dhe është raportuar në ndërfaqen e KQZ po nga Bashkia Librazhd. Në aktivitete, përveç pjesëmarrësve, ka qenë i pranishëm edhe drejtuesi politik i Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri.

Nga fjala e drejtuesit politik të Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, z. Damian Gjijnuri, rezulton ndër të tjera se ai është shprehur se *“Zgjedhjet duam t’i fitojmë, jo thjesht për të mbajtur flamurin e pushtetit sepse Partia Socialiste ka fituar gjithmonë në Librazhd. Qeveri – bashki të jemi një. Ne nuk duam që bashkitë tona të kthehen në luftëra politike. E vetmja gjë që thotë Sali Berisha është ky vend ka nevojë për revolucion për përmbysje. Pse do marrim armët ne do luftojmë, do përmbysim qeverinë tonë? Dëshirë vetëm ai ka për ta përmbysur. Njerëzit mund të kenë kritika dhe kritika e zhvillon shoqërinë. Berisha me Metën, që na janë bërë bashkë, duan si e si të kthehen në pushtet. Unë nuk shoh asnjë rrezik nga ata. Përveç dëshirës për destabilitet ata nuk ofrojnë asnjë alternativë zhvillimi. Nuk e pranon njeri as nga ndërkombëtarët. Ai ka hallin e tij. Ka ardhur dhe ish – presidenti e janë bërë bashkë. Thotë dhe ai: të më jepet dhe mua shansi. Njeri i stërprovuar që e ka tkurrur partinë, për shkak të imazhit, në nivele pothuajse të papërfillshme në elektorat”*.

Siç rezulton nga përmbajtja e fjalimit në aktivitetin e sipërcituar që është organizuar nga Bashkia Prrenjas, është mbajtur një fjalim me përmbajtje politike dhe elektorale nga drejtuesi politik i PS, madje janë anatemuar dhe kundërshtarët politikë të Partisë Socialiste, subjekt zgjedhor që ka propozuar z. Kastriot Gurra për kryetar të Bashkisë Librazhd.

Për mua anëtarin në pakicë, është e qartë njësoj si në rastin e Bashkisë Fier apo Bashkisë Prrrenjas, që shfrytëzimi i aktivitetit të organizuar nga Bashkia Librazhd për përcjelljen e mesazheve elektorale propagandistike në favor të partisë politike që ka mbështetur dhe mbështet kryetarin e bashkisë në detyrë apo anatemomi i kundërshtarëve politikë të kësaj partie, cënon sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike dhe krijon kushte të pabarabarta (disfavorizuese) për kandidatët e tjerë apo për partitë e tjera politike që marrin pjesë në zgjedhje.

Ndaj, për sa më sipër, KAS duhet të pranonte kërkesën e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryetarit të Bashkisë Librazhd, z. Kastriot Gurra.

4. Në lidhje me Bashkinë Lezhë, shumica e anëtarëve të KAS kanë arritur në konkluzionin se një nga aktivitetet e paraportuara nga Bashkia Lezhë, nuk është në shkelje të K.Zgjedhor sa i përket mosraportimit të tij, më konkretisht aktiviteti i promovimit të projektit “Dua të Luaj” që po zbatohet në qytetin e Lezhës. Për mua anëtarin në pakicë, mosraportimi i një aktiviteti që pavarësisht pjesëmarrjes apo jo të publikut në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitet, është në shkelje të K.Zgjedhor kur publiku informohet edhe nëpërmjet rrjeteve sociale për aktivitetin përkatës.

Që një aktivitet të raportohet, ai duhet të konsiderohet veprimtari publike. Në lidhje me “veprimtarinë publike” vetë K.Zgjedhor, në fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 92 të tij, parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*. Në lidhje me faktin nëse publikimet në faqen e Bashkisë Lezhë në rrjetin social *Facebook*, konsiderohen apo jo veprimtari publike, unë anëtari në pakicë vijoj të kem qasjen se së pari përdorimi i rrjeteve sociale patjetër që ka në agjendë informimin e publikut që është një nga kushtet e mjaftueshme për ta kualifikuar një veprimtari si publike, por së dyti përputhet dhe me interpretimin teleologjik (qëllimor) që i bëhet nenit 92 të K.Zgjedhor si dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore,

kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” në lidhje me vendosjen e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. **Për më tepër, masivizimi i përdorimit të rrjeteve sociale bën që propaganda kryesore të kryhet pikërisht nëpërmjet shpërndarjes së mesazheve/fotove/videove në to, çka do të thotë se moskonsiderimi i përdorimit të tyre si “veprimtari publike”, do t’i shndërronte dispozitat e sipërcituara si të pazbatueshme dhe për rrjedhojë nuk do të arrihej synimi për garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.**

Për sa më sipër, kërkesa e KSHZ për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës në Bashkinë Lezhë, për mua anëtarin në pakicë të KAS, është një kërkesë e bazuar në ligj dhe në prova edhe sa i përket këtij aktiviteti.

Anëtar: Ledio Braho